



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 99, Datë 27.05.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për funksionimin, organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1083/2 prot, datë 23.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 246, seria FK14, të shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 1083 prot., datë 14.05.2024 dhe nr. 1083/1 prot., datë 22.05.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 246 Seria FK14, është 22.12.2024).
- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 14.05.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “GSA” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a” dhe “c” nenin 16, pikën 7, si dhe si edhe shtojcës 1/I. Shoqëria duhet të informojë/depozitojë dokumentacionin përkatës si më poshtë:

Neni 16 Rinovimi i licencës

- **gërma “b”** çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë.

Në kuptim të kërkesave të këtij neni shoqëria duhet të dokumentojë/informojë në lidhje me dokumentacionin i cili nuk ka apo ka pësuar ndryshim nga koha në të cilën është bërë aplikimi i licencës aktuale që subjekti disponon.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 246, Seria FK14, të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin nr. 84, datë 16.09.2024 dhe rinovuar sërish me vendimin nr. 127, datë 13.08.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI